



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr. 230 prot.

Tiranë, më 19.02.2026

URDHËR

Nr. 33, Datë 19/02/2026

PËR

“RAPORTIMIN MUJOR DHE PROGRESIV MBI VEPRIMTARINË PROCEDURALE DHE ADMINISTRATIVE TË ZYRAVE PËRMBARIMORE VENDORE, KRYETARËVE TË ZYRAVE DHE PËRMBARUESVE GJYQËSORË SHTETËRORË ”

Në zbatim të nenit 8, të Ligjit nr. 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, shkresës nr. 292/1 Prot., datë 05.02.2026 të Ministrisë së Drejtësisë,

U R D H Ë R O J

1. Raportimin mujor dhe progresiv mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative të Zyrave Përmbarimore Vendore, Kryetarëve të zyrave dhe përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë.
2. Raportimi do të kryhet çdo datë 5 të muajit pasardhës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit me e –mal (në formatin word/excel dhe të skanuara), si dhe shkresërisht, sipas formatit statistikor tip 1, formatit statistikor tip 2, formatit statistikor tip 3 që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij.
3. Raportimi për të gjitha formatet statistikore do të jetë mujore dhe progresive, për zyrat përmbarimore vendore, kryetarët si dhe për çdo përmbarues gjyqësorë shtetërorë.
4. Specialisti i Çështjeve Ligjore dhe Statistikore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse mbledh, plotëson dhe administron raportimet mujore dhe progresive të zyrave përmbarimore vendore, kryetarëve dhe përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, në përfundim të së cilës përgatit raportimin mujor dhe progresiv për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, si dhe është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave.

- 
5. Plotësimi dhe përditësimi i të dhënave mujore dhe progresive kryhet brenda 5 ditëve pune nga momenti i depozitimit të informacionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbërimit, sipas pikës 2 të këtij urdhri, nga Specialisti i Çështjeve Ligjore dhe Statistikore.
 6. Raportimet mujore dhe progresive administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbërimit dhe përcillen për dijeni Ministrisë së Drejtësisë.
 7. Ngarkohen Kryetarët e Zyrave Përmbëimore Vendore, përmbëuesit gjyqësorë shtetërorë, Specialisti i Çështjeve Ligjore dhe Statistikore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij urdhri.
 8. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për monitorimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave, për përgatitjen e informacionit përfundimtar mbi raportimin mujor dhe progresiv të zyrave përmbëimore vendore, Kryetarëve dhe përmbëuesve gjyqësorë shtetërorë.
 9. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin e këtij urdhri.
 10. Urdhri nr. 440 Prot., nr. 36, datë 18.03.2025 dhe Urdhri nr. 79, datë 08.07.2025 i Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbërimit shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ERGYS QIRICI

